



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ**  
**SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR**

Maliq, më 22.01.2024

**Projekt-Vendim** - nr. 1

**PËR**

**“MIRATIMIN E PLANIT TË MBROJTJES SOCIALE 2024-2027”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” neni 36 “Roli i Bashkisë” ku përcaktohet se: “njësitë e qeverisjes vendore kanë përgjegjësinë për të planifikuar dhe buxhetuar shërbimet e përkujdesit social bazuar në vlerësimin e nevojave, identifikimin e burimeve financiare dhe partneriteteve vendore, bashkia harton planin e kujdesit social vendor.” I propozojmë Këshillit të Bashkisë Maliq të miratojë:

1. Planin e Mbrojtjes Sociale për vitet 2024-2027.
2. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit.

Konceptoi:  
Përgj. Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror:


(Emër Mbiemër)  
A. Lenja  
E. Petriti

Nënshkrimi

Data  
Dt 22.01.2024  
Dt 22.01.2024

**KRYETARI I BASHKISË**

**Gëzim Topçiu**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ  
SEKTORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR

Maliq, më 22.01.2024

RELACION


**“ MBI MIRATIMIN E PLANIT TË MBROJTJES SOCIALE 2024-2027”**

Plani i Mbrojtjes Sociale paraqet prioritetet e Bashkisë Maliq në fushën e zhvillimit social për periudhën 2024-2027. Plani do të shërbejë jo vetëm si pjesë e përfaqesjes strategjike për zhvillimin e Bashkisë në tërësi, por edhe si një nevojë për një qeverisje të mirë dhe demokratike, për të përmbushur përgjegjësinë ndaj qytetarëve për shërbime sociale të përshtatshme. Ky dokument do të jetë baza mbi të cilën do të mbështeten iniciativat e Bashkisë, shoqërisë civile, dhe ofruesve publik dhe privat të shërbimeve sociale, për zgjidhjen e problemeve sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë.

Në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore,” në nenin 24 përcaktohet se: “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale, të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, etj.” Gjithashtu, në Ligjin 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 36 “Roli i Bashkisë” përcaktohet se: “njësitë e qeverisjes vendore kanë përgjegjësinë për të planifikuar dhe buxhetuar shërbimet e përkujdesit social bazuar në vlerësimin e nevojave, identifikimin e burimeve financiare dhe partneriteteve vendore, bashkia harton planin e kujdesit social vendor.”

Plani i Mbrojtjes Sociale është një dokument politikash specifike për grupet dhe komunitetet e targetuara në territorin e bashkisë, në përputhje të plotë me Strategjinë e Mbrojtjes Sociale (2020-2023) dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2021-2030). Plani i Kujdesit Social është një dokument i bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse, i hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse vendore, shoqërisë civile si dhe grupeve në nevojë, për të garantuar një vlerësim sa më afër nevojave reale të grupeve dhe komuniteteve të ndryshme dhe mundësive për të adresuar këto nevoja nga aktorë të ndryshëm.

Plani i Mbrojtjes Sociale është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale. Ai shoqërohet gjithashtu me Planin e Veprimit (2024-2027), i cili është i ndarë në fushat e mëposhtme:



1. Qasja në shërbime sociale
2. Programe ndërgjegjësuese
3. Burimet njerëzore dhe kapacitetet
4. Shërbime dhe programe të mbështetura në evidencë
5. Informim, transparencë, dhe pjesëmarrje e banorëve në vendimmarrjen lokale

Konceptoi:


Përgj.Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror:

(Emër Mbiemër)

A.Lenja

E.Petriti

Nënshkrimi



Data

Dt 22.01.2024

Dt 22.01.2024

**KRYETARI I BASHKISË**

**Gëzim Topçiu**

